

**STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
PLAYGROUND BOX SHPK**

**KAPITULLI I
EMËRTIMI, SELIA, KOHËZGJATJA DHE OBJEKTI**

Neni 1 – Emërtimi i Shoqërisë

- 1.1 Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur **PLAYGROUND BOX SHPK** (këtej e tutje referuar edhe si "*Shoqëria*").
- 1.2 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2 – Vendi i ushtrimit të aktivitetit (Selia)

- 2.1 Vendi i ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë është në Rruga "Kodra e Diellit", Rezidenca "Kodra e Diellit", Z3, Nr.86, Selitë, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të hapë dhe/apo mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, në Shqipëri apo jashtë saj.

Neni 3 - Kohëzgjatja

- 3.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.
- 3.2 Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 4 – Objekti i Shoqërisë

- 4.1 Shoqëria ka për objekt planifikimin dhe organizimin e eventeve të ndryshme kulturore dhe artistike, shit-blerjen me pakicë dhe import-eksport të artikujve të ndryshëm të argëtimit për të rritur dhe fëmijë, pajisjeve të ndryshme për fëmijë, mobilie dhe aksesore të tyre, mjete kancelarike, bar-restorant, shërbime konsulence lidhur me sa më sipër; si dhe çdo veprimtari tjetër që lidhet, direkt apo indirekt, me sa më sipër. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo lloj aktiviteti lidhur me shitblerjen e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, si edhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qiradhënje apo qiramarrje apo dorëzanie, që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj.
- 4.2 Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose të fitojë interesa, direkt ose indirekt, në shoqëri, organizata, agjensi dhe ndërmarrje të tjera, të cilat mund të kenë edhe objekte të tjera aktiviteti.

**KAPITULLI II
KAPITALI THEMELTAR, RITJJA DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE**

Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 1000 Lekë (njëmijë), i përbërë nga 1 (një) kuotë me një vlerë nominale prej 1000 Lekë (njëmijë).
- 5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë është nënshkruar në para dhe paguar plotësisht si më poshtë vijon:

- **Florjan Piperi**, shtetas shqiptar, lindur në Vlorë, më datë 5 mars 1978, me banim Tiranë, Shqipëri, me nr. ID H80305061H, i cili ka kontribuar me para në kapitalin e Shoqërisë me një shumë të barabartë me 1000 (njëmijë) Lekë

- 5.3 Në bazë të kontributeve të sipërcituara, në momentin e themelimit:


Florjan Piperi zotëron 1 (një) kuotë, e barabartë me 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar

Neni 6 – Rritja e kapitalit themeltar

Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me oferte për një apo disa nga ortakët ekzistues apo me oferte për të treta, sipas modaliteteve dhe rrethanave me të cilat lidhet rritja e kapitalit, sic do të përcaktohet në vendimin e Asamblese.

Neni 7 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 7.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo



rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.

- 7.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 8 – Transferimi i kuotave

- 8.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 8.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.
- 8.3 Në rast se një ortak do të transferojë një pjesë ose të gjithë kuotat e tij ("Ofertuesi") duhet të njoftoj me shkrim ortakët e tjerë ("Ortakët e Tjerë"), me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar numrin e kuotave, çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit ("Oferta"). E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjitha kuotave të ofruar për shitje ("Kuotat e Ofruara").
- 8.4 Ortakët e Tjerë do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar Ofertuesit, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 8.5 Në rast se vetëm disa nga Ortakët e Tjerë dëshirojnë të blejnë Kuotat e Ofruara, secili prej tyre ka të drejtë të blejë Kuotat e Ofruara në mënyrë të përpjesshme me kuotat që ata zotërojnë, përveçse kur parashikohet ndryshe. Në asnjë rast, përfituesi nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 8.6 Në rast se asnjë nga Ortakët e Tjerë nuk zgjedhë të blejë Kuotat e Ofruara, Ofertuesi ka të drejtë t'u transferojë të tretëve Kuotat e Ofruara plotësisht apo pjesërisht, me pëlqimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme.
- 8.7 Në rast të transferimit të kuotave për shkak trashëgimie *mortis causa* ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj. Në rast se nuk jepet pëlqimi, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Përgjithshme.

KAPITULLI III ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 9 – Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj

- 9.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.
- 9.2 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese:
- ndryshimet e statutit
 - emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve
 - zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit
 - transferimi i kuotave
 - shpërndarja e fitimeve
 - riorganizimi dhe prishja e shoqërisë
 - miratimi i bilancit
 - dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkatës.

Neni 10 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

- 10.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble e Përgjithshme, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron.
- 10.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person i pajisur me prokurë me shkrim, i cili nuk duhet të jetë domosdoshmërisht një ortak tjetër. Në çdo rast, prokura mund të jetë vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.
- 10.3 Ortaku nuk mund të autorizojë asnjë përfaqësues për të votuar sipas një pjese të kapitalit që ai zotëron në Shoqëri ndërsa voton personalisht sipas pjesës së mbetur.

Neni 11 – Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi dhe vendimet

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit

- financiar për miratimin e inventarit dhe bilancit, të raportit të Administratorit/ëve, si dhe raportin ekspertit kontabël (nëse është emëruar).
- 11.2 Asambleja Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/ët ose nga një ose disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar.
- 11.3 Asambleja Përgjithshme duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje apo mesazh elektronik (e-mail) të njohur për secilin ortak – dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 8 (tetë) ditë përpara mbledhjes. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë Përgjithshme, rendin e ditës, vendin, orën dhe datën e thirrjes. Për këto qëllime, secili ortak ka detyrimin të perditesoje të dhenat e tij të kontaktit, nëse ato ndryshojnë, tek Administratori.
- 11.4 Asambleja Përgjithshme mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë shtetit.
- 11.5 Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk mbledhet me thirrjen e parë për mungesën e kuorumit të parashikuar në pikën 11.7 të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme do të thirret brenda 10 (dhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.
- 11.6 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahen edhe nëpërmjet audio apo videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen nga kryetari dhe u lejohet të ndjekin diskutimin dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes.
- 11.7 Asambleja e Përgjithshme konsiderohet e thirrur dhe zhvilluar rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të gjithë kapitalin themeltar dhe të gjithë ortakët janë dakord të marrin vendime pavarësisht parregullsisë së njoftimit.
- 11.8 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat është e nevojshme një shumicë e zakonshme, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 31% (tridhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja e Përgjithshme merr vendimet në mbledhje të zakonshme me votën pro të shumicës së ortakëve të pranishëm.
- 11.9 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat është e nevojshme një shumicë e cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë të paktën 51% (pesedhjetë e një përqind) e kapitalit themeltar. Në këto raste, Asambleja e Përgjithshme vendos me votën pro të të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katërtave) të ortakëve pjesëmarrës për: ndryshimet e statutit, rriadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, transferimin e kuotave, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, çdo investim, marrje huaje, vendosje barre mbi asetet e Shoqërisë ose vendim tjetër për marrje përsipër detyrimi nga Shoqëria që kalon vlerën 10.000,00 Euro, emërim i financierit dhe kontabilistit të Shoqërisë, dhënie e huave ose pagesave paraprake nga Shoqëria për nevojat e Ortakëve, administratorëve apo punonjësve, miratimi i pagave vjetore bruto, kompesimeve ose shpërblimeve për punonjësit në një vlerë më të madhe se 5.000,00 Euro, miratim i buxhetit vjetor të Shoqërisë apo miratimi i shpenzimeve apo investimeve që nuk janë miratuar në buxhetin vjetor.
- 11.10 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme drejtohen nga kryetari i zgjedhur nga rradha e ortakëve ose personave të tjerë. Asambleja e Përgjithshme emëron një Sekretar për mbajtur procesverbalet i cili mund të jetë edhe jo-ortak.
- 11.11 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të nënshkruhen bashkërisht nga Kryetari dhe Sekretari.

Neni 12 – Administratori/ët

- 12.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë, të cilët do të veprojnë si veçmas ashtu edhe së bashku. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim, dorëheqje apo për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë rizgjedhje. Nëse Asambleja nuk vendos përpara përfundimit të këtij afati, mandati do të rinovohet automatikisht sipas afatit të përcaktuar në këtë Statut.
- 12.2 Shoqëria përfaqësohet ligjërisht nga Administratori/ët. Administratorët mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe jashtëzakonshëm të Shoqërisë në përputhje me Ligjin nr. 9901, datës 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. Në vecanti, Administratori mund të veprojë veçmas për sa me poshte:
- punesimin apo shkarkimin e punonjësve të Shoqërisë;
 - marrjen përsiper nga ana e Shoqërisë se çdo detyrim deri në vlerë 10.000 EUR;
 - përcaktimin e furnitoreve dhe partnerëve të tjerë tregtar të Shoqërisë;
 - në situata urgjente apo rrethana të tjera që është e pamundur të pritet mbledhja e Asamblesë, mund të kryejë veprime jashtë tagrit të zakonshëm të aktivitetit të tij, me kushtin që të konsiderohen të domosdoshme dhe në interesin me të mire të Shoqërisë, dhe duhet të kerkojë konfirmimin e Asamblesë për veprimin në fjale në mbledhjen me të parë të Shoqërisë apo të kerkojë thirrjen e

Asamblese per ke te qellim.

- 12.3 Administratorët mund të emërojnë një përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh brenda kufiit të tyre të kompetencave.

Neni 13 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 13.1 Nëse është e nevojshme, kërkohet nga ligji ose vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë kryehet një ose disa ekspertë kontabël të autorizuar.
- 13.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni përkatës.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 14 – Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor

- 14.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 14.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 14.3 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit/ëve dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
- 14.4 Dokumenta që lidhen me vitin financiar duhet të miratohen brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar, në çdo rast brenda afateve ligjore.

Neni 15 – Fitimet

- 15.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara prej tyre.
- 15.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë, për qëllime të posaçme, krijimin e rezervave të posaçme apo të jashtëzakonshme ose të shtyjë shpërndarjen e fitimeve, tërësisht apo pjesërisht.

KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI

Neni 16 – Shpërndarja


- 16.1 Shoqëria mund të prishet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme apo në rastet e parashikuara nga ligji.
- 16.2 Shoqëria nuk prishet për shkak të paafësisë për të vepruar, pengesave ligjore, vdekjes, likuidimit apo falimentimit të ortakëve.

Neni 17 – Likuidimi

- 17.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 17.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose disa likuidues të cilët do të paraqesin raportin përfundimtar likuidimi mbi asetet dhe detyrimet e Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme të likuidimit.
- 17.3 Në fund të procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesi/t dhe përfundimin e procesit të likuidimit.
- 17.4 Pas pagesës së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive të maturuara, likuiduesi/t u shpërndajnë ortakëve asetet e mbetura pas likuidimit në përpjesëtim me pjesët e kapitalit të zotëruar prej tyre.

KAPITULLI VI TË NDRYSHME

Neni 18 – Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve



- 18.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, si edhe ato që mund të lindin midis ortakëve ose midis një apo disa ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore nga palët e interesuara.
- 18.2 Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet në mënyrë miqësore, ajo i paraqitet Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, përveç kur ndonjë prej ortakëve vendos t'ia nënshtrojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes një Gjykate Arbitraze.

Neni 19 – Gjuha

Ky Statut është hartuar në gjuhën shqipe.

Flora Pipaul

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Flora Pipaul', with a large, stylized flourish extending to the right.